



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

OSHP. nr. 1171/24

Sekretariati i Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik duke u bazuar në nenin 98 paragrafi 2 si dhe nenin 99 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës, dhe konform nenit 32 të Rregullores së punës së OSHP-së nr. 01/2020 (e amendamentuar), pas shqyrtimit të kërkesës së AK – Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me numër 1171/24, për zbatim të nenit 99.2 LPP-së, ndaj A.L. Dushi Sh.p.k, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Sherbimet postare diplomatike, me nr: te prokurimit: 216-23-13152-2-1-1, iniciuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më: datë 03.02.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET**, si e pa bazuar kërkesa e Autoritetit Kontraktues – Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin publik të OE A.L. Dushi Sh.p.k, me nr: unik 811250860 - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Sherbimet postare diplomatike, me nr: te prokurimit: 216-23-13152-2-1-1, iniciuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

ARSYETIM

Kërkesa e AK- Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës:

Autoriteti Kontraktues pretendon se O."A.L. Dushi" Sh.p.k, si pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit me titull: "Shërbimet postare diplomatike" me nr. të prokurimit: 216-23-13152-2-1-1, e kemi rekomanduar për kontratë dhe e kemi nënshkruar kontratën me operatorin ekonomik në fjalë, dhe i njëjti edhe pas disa kërkesave për zbatim të kontratës i njëjti nuk ka arritur ta përmbush kontratën për projektin e cituar me lartë dhe si autoritet kontraktues kemi vepruar sipas dispozitive të LPP-se, duke e shkëputur kontratën me vendim. Pra, autoriteti kontraktues kërkon marrjen e masave sipas nenit 99.2 të LPP-se, me arsyetimin se OE A.L. Dushi Sh.p.k, nuk e ka përmbushur kontratën.

Kërkesa e OSHP-se drejtuar Operatorit Ekonomik:

Organi Shqyrtues i Prokurimit, me të pranuar kërkesën e datës: 27.12.2024, të AK - Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, e ka njoftuar OE."A.L Dushi" Sh.p.k, me qëllim që operatori ekonomik në fjalë të jap faktet dhe argumentet e veta lidhur me kërkesën e AK-së.

OE. "A.L. Dushi" Sh.p.k, në përgjigje ka kërkuar fillimisht që kërkesa e AK-MPJD-se, të refuzohet me arsyetimin se nuk janë plotësuar kushtet e parapara në nenin 99.2 të LPP-së, dhe ngehurit ka dhënë faktet dhe argumentet e veta lidhur me kërkesën e AK-se.

OSHP pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të kërkesës së Autoritetit Kontraktues dhe arsyeshmërisë së dhënë nga OE konstaton se Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, nuk ka dorëzuar asnjë provë që dëshmon se OE."A.L. Dushi" Sh.p.k, në këtë aktivitet të prokurimit, ka mashtruar apo ka falsifikuar ndonjë dokument apo dëshmi, për të cilën OSHP, mund të marrë masa konkrete ndaj operatorit ekonomik.

OSHP mund të marrë masa ndaj operatorëve ekonomik vetëm nëse AK-ja, ka ofruar prova ashtu siç potencohet në nenin 99 të LPP-së, në të cilin flitet për funksionet dhe kompetencat e OSHP-së, në paragrafin 2 të këtij neni, ku thuhet: "*Në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare*", e që në rastin konkret AK-ja, nuk ka arritur të ofroj ndonjë dëshmi apo prove për paraqitje të dokumenteve të rreme apo të falsifikuara nga ana e OE A.L. Dushi Sh.p.k, për aktivitetin e prokurimit: "Shërbimet postare diplomatike", me nr. të prokurimit: 216-23-13152-2-1-1.

Prandaj, në rastin konkret vlerësoj se palët kontraktuale në kontratën e lidhur me datën 14.06.2024 nuk kanë arritur ti zgjedhin në mënyrë miqësore mosmarrëveshjet që kanë pasur, andaj sipas kushteve të veçanta të kontratës të parapara në nenin 21 paragrafi 1, palët mund ti referohen

Gjykatës kompetente, sepse ne rastin konkret nuk kemi te bëjmë me mashtrim apo falsifikim sipas dispozitave te nenit 99.2 te LPP-se. Sipas paragrafin 1 te nenit 21 ne kushteve e kontrates vet palet e kanë parapare qe ti drejtohen Gjykatës kompetente ne rast se kanë mosmarrëveshje gjate realizimit te kontrates.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund drejtohet Gjykatës kompetente për anulim vendimi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Ministrise se Punëve të Jashtme dhe Diasporës

1x1 OE A.L. Dushi

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

UD. Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së
Agim SHEQIRI

